



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite - Ministry of Labour and Social Welfare

Raport

Me kërkesën e kryeministrat të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Ramush Haradinaj, prezantoj këtë raport i cili ka për qëllim prezantimin e punës dhe angazhimit tim dhe të Departamentit të Familjeve të Dëshmorëve,Invalidëve të Luftës dhe Viktimate Civile, për të cilin jam i ngarkuar pranë MPMS.

Ky rapport gjithëpërfshirës është

një mundësi e mirë për të informuar lidhur me punën dhe aktivitetet që zhvillohen në kuadër të DFDIL, e po ashtu ka për qëllim që t'i nënvojizojë progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të MPMS, me theks të veçantë progresin e arritur në këtë fushë. Në këtë aspekt, ky rapport ka si pikë reference programin MPMS, në kuadër të të cilit nënvojohen prioritetet e sajë strategjike të përcaktuara për këtë vit. Po ashtu ky rapport është një mjet i mirë komunikimi që tregon, përkushtimin, angazhimin dhe vendosmérinë e treguar në përbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së kategorive të dala nga lufta.

Me pranimin e detyrës zv.ministër, kontakti im i parë zyrtar ka qenë me ministrin e MPMS, z. Skender Recica, me të cilin kemi diskutuar për misionin, objektivat dhe prioritetet e ministrisë si dhe për ndarjen e detyrave dhe angazhimin tim në kuadër të ministrisë konkretisht me Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve,Invalidëve të Luftës dhe Viktimate Civile.

Fillimisht fokusi im ka qenë vendosja e kontakteve me akterët kryesor të cilët merren me këtë fushë, se pari kam vizituar DFDIL, drejtoreshen dhe punetoret nëpër zyre me të cilët kemi vure, ura bashkëpunimi dhe komunikimi të rregullta, qëllimi i këtyre takimeve ka qenë, njojja dhe bashkëpunimi si mundësi e mirë për t'u informuar lidhur me të gjitha të arriturat por edhe me problematikat dhe vështirësitë që kanë gjatë ushtrimit të detyrave në vendin e punës.

Po ashtu takime me organizata të dala nga lufta të Ushtorisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilët kemi biseduar për bashkëpunimin më të mirë me MPMS dhe me institucionet e Republikës së Kosovës, për gjendjen e veteranëve, invalidëve si dhe familjet e tyre dhe familjeve të dëshmorëve.

Vizita nëpër familje të dëshmorëve dhe martirëve të kombit, e po ashtu pjesëmarrja në aktivitetet e shumta përkujtimore që bëhen në nderim të rënëve për liri.

Duke shikuar fushëveprimtarinë e këtij depertamenti si dhe detyrat dhe përgjegjësitë siq janë: Hartimi dhe promovimi i politikave të MPMS-së nga fusha e pensioneve dhe benefacioneve për kategoritë e luftës, si dhe detyrat tjera të cilata janë përshkruar në detaj, nga marrja e detyrës kam vendos si objektiv timin që së bashku me përgjegjësitë e departamentit të angazhohemi maksimalisht në zbatimin e ligjit për këto kategori si dhe realizimin e obligimeve dhe detyrave që kanë për qëllim:

Përkrahjen e vazhdueshme dhe përmirësimin e mirëqenies dhe mbështetja e kategorive të dalura nga lufta:

1. Realizimi i pensioneve dhe benefacioneve për invalidët, familjet dëshmorëve dhe familjeve të zhdukurve
2. Realizimi i skemës së pensioneve për veteranët e UÇK-së
3. Mbështetja dhe realizimi i përfitimeve për viktimat e dhunës sekusuale të luftës
4. Zbatimi i memorandumeve të mirëkuptimit për mbështetjen e shoqatave të dalura nga lufta, për rehabilitimin e këtyre kategorive.
5. Krijimi i hapësirës dhe kushteve të nevojshme për Komisionin Mjekesore, me qëllim të mbarëvajtjës së punës në kushte normale, në mënyrë që në afatin sa më të shpejtë që të jetë e mundur të përfundojnë verifikimin dhe klasifikimin e të gjithë atyre që kanë aplikuar për invalid të luftës.

Departamenti i DFDIL-së ushtron veprimtarinë e vetë në tri divizionë:

Divizioni i Skemave për Kategoritë e Luftës;

Divizioni për Realizimin e të Drejtave

Divizioni i Monitorimit dhe Kontrollit dhe

Shtatë Zyra Regionale të Kosovës, të zyrtarët përgjegjës nëpër zyre kam parë një përkushtim dhe vullnet të shtuar që të ju përgjigjën të gjitha

kërkesave për kategoritë e luftës, në bazë të Ligjit, duke pas parasyshë se kemi të bëjmë me kategoritë me kontribueset për shoqerinë tonë por në të njëjtën kohë edhe më të ndjeshme të shoqerisë. Po ashtu gjatë vizitave nëpër zyra është vërejtur mungesa e stafit dhe pajisjeve që paraqesin vështirësi në punë.

Në tre mujorin e parë të vitit 2018-të, nëpër zyrat e DFDIL-së ka vazhduar organizimi i punëve, menaxhimi, kontrolli për aplikimet në të gjitha kategoritë.

Në vazhdimësi janë bërë shqyrtimet e ankesave të palëve si dhe përgjigjja ndaj këtyre ankesave. Është bërë pranimi i lëndëve, shqyrtimi i tyre, po ashtu edhe kontrollimi i tyre. Është bërë monitorimi dhe vizita nëpër terren për raste të ndryshme.

Ka filluar aplikimi i rasteve të dhunuarve gjatë luftës.

Nga 2011, me një vendim të ministrit të asaj kohe, është ndërrprerë puna e Komisionit Mjekesor për Invalidët e Luftës dhe Invalidët Civil të Luftës.

Me 1 dhjetor është nënshkruar Vendimi nga Ministri i MPMS-së që mund të filloj aplikimi për të gjitha kategoritë e Luftës që kanë qënë të ndaluara me Vendim të ish Ministrit Rashiq.

Ka filluar mbajtjen e seancave prej 22.01.2018 për invalidët e luftës dhe invalidët civil të luftës dhe ka vazhduar në mbajtjen e tyre si dhe shqyrtimin e kërkesave të invalidëve.

Aplikimi është duke vazhduar për të gjitha rastet e reja që nuk kanë gjetur zbatim deri tanë .

Në tabelat e paraqitura është numri i përfituesve të gjitha kategorive të luftës.

Numri i përfituesve të veteranëve			
Deri me	Skema	Të regjistruar	Në pagesë
Veteranët e UÇK-së		39337	38253

Famijlet e Veteranëve pas vdekjes	1704	1663
-----------------------------------	------	------

Skema	Numri i përfituesve sipas skemës	
	Të regjistruar	Në pagesë
Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së	2967	2469
Familjet e Viktimave Civile	6306	5220
Familjet e të Zhdukurëve të UÇK-së	23	21
Familja e të Zhdukurëve Civil	477	416
Familjet e Invalidëve të Luftës pas vdekjes	182	178
Familjet e Invalidëve Civil pas vdekjes	138	125
Invalid Civil të Luftës	4159	2254
Invalidët e Luftës të UÇK-së	4577	3544
Kujdestarët për Invalidët të Luftës	89	83
Kujdestarët për Invalidët Civil	49	45

Dati me 31.03.2018

Me respekt !

Abdyl Ymeri, Zv.ministër në MPMS